



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 19.05.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.196/016-26756

-Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Nedzad Radoncic - zyrtar ligjor - Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim regional "CLARD" me seli në Prishtinë, Komuna Prishtinë, me 07 Nr.016-26756 të datës 06.05.2022, në të cilën kërkon dhënien e lejes për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një shtandi mobil për promovim të kampanjës "Edukimi kundër dhunës në familje dhe ngacmimit seksual", në bazë të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 dhe Rregullores - 01 Nr. 16-4719 dt. 30.06.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private, lëshon këtë:

P Ë L Q I M

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Nedzad Radoncic - CLARD	Nr. Personal	
Adresa:	Rr."Bardhyl Qaushi"-Nr.7 Prishtinë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim - leje për Sh.h.p. për vendosjen e një tende (shtandi mobil) për promovim të kampanjës "Edukimi kundër dhunës në familje dhe ngacmimit seksual" në sheshin "Ibrahim Rugova" në Suharekë.

Përshkrimi:

- **I LEJOHET** - z. Nedzad Radoncic - zyrtar ligjor - Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim regional "CLARD" me seli në Prishtinë, Komuna Prishtinë, - shfrytëzimi i hapsirës publike për vendosjen e një tende (shtandi lëvizës mobil) për promovim të kampanjës "Edukimi kundër dhunës në familje dhe ngacmimit seksual" në qytetin e Suharekë .

-Ushtrimi i aktivitetit, vendosja e një objekti të përkohshëm - tendë (shtand lëvizës mobil) - për promovim të kampanjës në fjalë, do të bëhet në parcelën kadastrale Nr. 680-1, pasuri shoqërore, zona kadastrale Suharekë, në rrugën "Brigada-123" - në vendin e quajtur sheshi "Ibrahim Rugova" në Suharekë .

-Shfrytëzimi i hapsirës publike për vendosjen e objektit të përkohshëm, ushtrimi i aktivitetit të cekur më lartë, është me karakter të përkohshëm dhe me datë të caktuar: **dt. 19.05.2022**, nga ora **10.00h** deri më **14.00h**.

- Investuesi gjegjësisht shfrytëzuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër dhe pas përfundimit ta kthejë në gjendjen e mëparshme .

A r s y e t i m

Pranë Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit të Komunës së Suharekës ka parashtruar kërkesë z. Nedzad Radoncic - zyrtar ligjor - Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim regional "CLARD" me seli në Prishtinë, Komuna Prishtinë, - në të cilën ka kërkuar pëlqim për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një tende (shtandi lëvizës mobil) për promovim të kampanjës

Faqe1nga2

“Edukimi kundër dhunës në familje dhe ngacmimit seksual”, në parcelën kadastrale Nr. 680-1, pasuri shoqërore, zona kadastrale Suharekë, në rrugën “Brigada-123” - vendi i quajtur sheshi “Ibrahim Rugova” në qytetin e Suharekës .

- Ky organ pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkëngjitura, ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës mundë të i jepet leja përkatësisht **PËLQIMI** për zhvillimin e aktiviteteve të lartpërmendura.

Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese – MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit .

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal, Dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës:

Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë
Visar Kuçi

